



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF
HEALTH**

Raporti i llogarive kombëtare të shëndetësisë 2020

Prishtinë,

Korrik 2022

Parathënje

Llogaritë kombëtare të shëndetësisë janë një proces përmes të cilit vendet monitorojnë rrjedhën e parave në sektorin e tyre shëndetësor, duke parë perspektiva të ndryshme të financimit të shëndetit. Organizata Botërore e Shëndetësisë është duke koordinuar përpjekjet në nivelin global për të hartuar vlerësime të tilla për secilin shtet.

Llogaritë kombëtare të shëndetësisë paraqesin informacion bazik për krijimin e analizave dhe formulimeve të politikave të bazuara në të dhëna, duke mundësuar të kuptuarit e burimeve dhe përdorimin e të gjitha fondeve (publike, private dhe kontributin nga donatorët) në sektorin e kujdesit shëndetësor.

Llogaritë kombëtare të shëndetësisë duhet të ndihmojnë Ministrinë e Shëndetësisë dhe palët e tjera interesuara për të kuptuar dinamikën e shpenzimeve të kujdesit shëndetësor në vend dhe për të përmirësuar rregullimin e përgjithshëm të sektorit shëndetësor. Një informacion i tillë, i shoqëruar me përmirësime të cilësisë dhe qasja në statistikat e tjera shëndetësore duhet të formojë bazën për monitorimin e performancës së sistemit të kujdesit shëndetësor.

Tabela e përmbajtja

Parathënje	2
Figura.....	4
Lista e shkurtesave.....	5
1. Hyrje	6
2. Metodologjia.....	7
3. Demografia e Kosovës.....	9
4. Financimi i sistemit shëndetësor në retrospektivë.....	12
5. Financimi i sistemit shëndetësor në vitin 2020	18
5.1. Sektori publik.....	18
5.2. Sektori Privat	21
6. Konkluzione dhe rekomandime	24
7. Aneksat - Grafikët nga softueri HAPT.....	25

DRAFT - Raporti NHA 2020 - Versioni 1.4 - 02 Qershor 2022

Figura

<u>Figura 1. -Ndarja administrative e Kosovës.....</u>	9
<u>Figura 2. -Jetëgjatësia e pritshme në lindje - 2011 (ASK, 2021).....</u>	10
<u>Figura 3- Piramida e popullsisë - 2020 (ASK, 2020).....</u>	11

Tabelat

<u>Tabela.1 - Popullsia sipas grupmoshave</u>	10
<u>Tabela 2.- Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2020</u>	11
<u>Tabela 3. - Shpenzimet në Ministrinë e Shëndetësisë, për vitet 2010 - 2020, sipas kategorive ekonomike (në Euro).....</u>	14
<u>Tabela 4. - Shpenzimet në SHSKUK, për vitet 2015 - 2020, sipas kategorive ekonomike (në Euro).....</u>	14
<u>Tabela 5. - Shpenzimet në KPSH, për vitet 2010 - 2020, sipas kategorive ekonomike (në Euro).....</u>	15
<u>Tabela 6. - Shpenzimet e dikastereve të tjera të sektorit publik për shëndetësi, ne vitin 2020 (në Euro):.....</u>	15
<u>Tabela 7. -Shpenzimet për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, për vitin 2020, sipas kategorive ekonomike (në Euro):.....</u>	16
<u>Tabela 8. -Shpenzimet e sektorit publik për shëndetësi, 2010-2020 (në Euro):</u>	16
<u>Tabela 9. -BPV, dhe % e BPV -së për shëndetësi (total) 2015-2020 (në milionë Euro).....</u>	17
<u>Tabela 10. -Kredi në MSH, sipas kategorive ekonomike.....</u>	19
<u>Tabela 11. -Donacionet, sipas kategorive ekonomike</u>	19
<u>Tabela 12. -Donacionet e pranuar nga institucionet shëndetësore</u>	19
<u>Tabela 13. -Përmbledhje: Struktura e shpenzimeve për shpenzuesit kryesor publik (me donacionet), per vitin 2020.....</u>	20
<u>Tabela 14. -Shpenzimet nga xhepi i qytetarit për shëndetësi të disagreguara në nënkategori, 2020:</u>	21
<u>Tabela 15.-Shpenzimet për sigurimin shëndetësor vullnetar, 2020</u>	22
<u>Tabela 16. -Total shpenzimet për shëndetësi ne vitin 2020</u>	23

Aneksat

<u>Aneksi 1 - Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetësi nga te gjitha nivelet e financimit</u>	25
<u>Aneksi 2 - Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetsi te financuara nga Granti Qeveritar.....</u>	26
<u>Aneksi 3 - Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetësi nga kompanitë private te sigurimeve.....</u>	27
<u>Aneksi 4 - Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetësi nga pagesat nga xhepi..</u>	28
<u>Aneksi 5 - Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetësi te financuara nga donatorët</u>	29

Lista e shkurtesave

MSH	Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
HAPT	Health Accounts Production Tool
ASK	Agjencia e Statistikës së Kosovës
KPSH	Kujdesi parësor shëndetësor
KDSH	Kujdesi dytësor shëndetësor
KTSH	Kujdesi tretësor shëndetësor
BB	Banka Botërore
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
AMF	Ambulanca e Mjekësisë Familjare
MD	Ministria e Drejtësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
FSSH	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
BPV	Bruto Produkti Vendor
LLK	Llogaritë Kombëtare
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
FS	Të ardhurat e skemave të financimit të kujdesit shëndetësor (Revenues of health care financing schemes)
HF	Skemat e financimit (Financing schemes)
HP	Ofruesit e kujdesit shëndetësor (Health care providers)
HC	Funksionet e kujdesit shëndetësor (Health care functions)
HK	Investime Kapitale (Capital Account)

1. Hyrje

Ky dokument ka për synim përmbledhjen e të gjitha shpenzimeve për shëndetësi, përfshirë shpenzimet shëndetësore të sektorit publik, atij privat, dhe të gjitha donacionet gjatë vitit 2020, dhe duke i vendosur ne softëare-in përkatës të dizajnuar nga OBSH, për të pasqyruar sa më qartë financimin e sektorit shëndetësor në vend.

Dokumenti është përpiluar nga Komisioni ndër dikasterial për raportimin e llogarive kombëtare të shëndetësisë:

- z. Arsim Qavdarbasha, Ministria e Shëndetësisë;
- znj. Kadrije Berisha, Ministria e Shëndetësisë;
- z. Liridon Dervishaj, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore;
- znj. Esida Bujupi, Divizioni i Politikave Makroekonomike, MFPT;
- znj. Nazmie Fazliu, Departamenti i Buxhetit, MFPT;
- z. Halim Kastrati, Thesari, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- znj. Luljeta Selimi, Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- znj. Vjosa Kalaja, Ministria e Shëndetësisë;
- z. Ragip Hyseni, Ministria e Shëndetësisë dhe
- znj. Kosovare Murseli, Ministria e Shëndetësisë.

Për të përpiluar këtë raport, komisioni në fjalë ka shfrytëzuar asistencën dhe bashkëpunimin me Zyrën e OBSH në Republikën e Kosovës, dhe ekspertizën e konsulentëve të OBSH – së. Raporti përgatitet përmes softuerit të HAPT (Health Accounts Production Tool), modul standard i OBSH për të gjitha vendet të cilat raportojnë. Të gjitha shumat e përdorura në këtë Raport janë në *Euro*, përveç nëse është shënuar ndryshe në tabelë.

Raporti synon informimin në detaje për shpenzimet publike dhe private në shëndetësi për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe më gjerë; si dhe informata mbi sistemin shëndetësor në përgjithësi në Kosovë, përkatësisht shërbimet e ofruara nga sistemi shëndetësor (publik) në Kosovë, si dhe të dhëna mbi burimet njerëzore në sistemin shëndetësor.

Synimi specifik i këtij raporti është bashkërendimi i mënyrës tonë të raportimit të shpenzimeve me atë të OBSH-së duke shfrytëzuar softuerin HAPT. Për të gjithë ata që janë të interesuar të kuptojnë më mirë këtë mënyrë të raportimit (sistemin e llogarive shëndetësore sipas OBSH), shihni vegëzën në fusnotën e kësaj fjalie.¹

¹ Sistemi i llogarive shëndetësore (Health Accounts) sipas OBSH:
https://score.tools.who.int/fileadmin/uploads/score/Documents/Optimize_Health_Service_Data/SHA2011/System%20of%20Health%20Accounts_2017.pdf

2. Metodologjia

Analiza e financimit të shëndetësisë në Kosovë, megjithë vazhdimin e problemeve për krijimin e kapaciteteve profesionale përkatëse për këtë proces, ka vazhduar me përgatitjet dhe hartimin e raportit të llogarive kombëtare të shëndetësisë 2020, me këtë metodologji:

Për hartimin e këtij Raporti janë përdorur burime të ndryshme të të dhënave, si Raportet e Departamentit të Buxhetit dhe Financave të Ministrisë së Shëndetësisë, Raportet e donacioneve nga Departamenti i Integritimit evropian dhe koordinimit të politikave të Ministrisë së Shëndetësisë, Raportet e Thesarit të Ministrisë së Financave për buxhetet e MSh, FSSH, SHSKUK dhe Komunave; Raportet e Makroekonomisë së Ministrisë së Financave, të dhënat e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, të dhënat e shpenzimeve për shëndetësi të dikastereve të tjerë, të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës, etj.

Sa i përket sektorit privat, u vendos që si burimi me adekuat i të dhënave të shfrytëzohet Anketa e shpenzimit të Ekonomive familjare, anketë kjo që zhvillohet nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës, në baza periodike. Shpenzimet nga sektori privat, apo siç quhen shpenzimet nga xhepi (*out-of-pocket payments*), janë të vetmet shpenzime për të cilat janë përdorur supozime për t'i vlerësuar. Ndryshe nga shpenzimet nga xhepi, të gjitha shpenzimet tjera janë aktuale.

Për t'i vlerësuar këto shpenzime është ndjekur metodologjia në vijim: përqindja e shpenzimeve të ekonomive familjare në shëndetësi ndaj shpenzimeve totale të ekonomive familjare (e marrë nga Anketa e Shpenzimeve të Ekonomive Familjare – nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës) është shumëzuar me vlerën nominale të konsumit privat (apo të konsumit final të ekonomive familjare) të marrë nga Llogaritë Kombëtare të publikuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Shih formulën në vijim për më tepër.

$$\begin{aligned} & \text{Shpenzimet nga xhepi, apo private (out – of – pocket payments)} \\ &= \frac{\text{Shpenzimet e ekonomive familjare në shëndetësi}}{\text{Shpenzimet totale të ekonomive familjare}} \\ & \times \text{Vlera nominale e konsumit privat} \end{aligned}$$

Gjithashtu, shpenzimet specifike në kategorinë e shpenzimeve nga xhepi janë ndarë në bazë të të dhënave të disagreguara të marra prapë nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Ky vlerësim është i bazuar në metodologjinë e zhvilluar dhe nga konsulentët e angazhuar nga OBSH për të ofruar asistencë teknike tek Ministria e Shëndetësisë në Kosovë.

Janë identifikuar dy kufizime apo, thënë më mirë sqarime, sa i përket kësaj metodologjie:

- a) vlerësimi i shpenzimeve nga xhepi (*out-of-pocket payments*), siç u cek edhe më lart, ndryshe nga të gjitha shpenzimet tjera të cilat janë të bazuara në të dhëna aktuale, shpenzimet nga xhepi janë një vlerësim, meqë bazohet në të dhënat të rrumbullakuara (pa presje decimale), e ku çdo shifër shtesë mund të ndryshojë shumën totale konsiderueshëm.
- b) Edhe kjo pikë ka përsëri ka të bëjë me shpenzimet nga xhepi – specifiku rreth faktit se në vitin 2020 janë përdorur të dhënat nga Anketa e Shpenzimeve të Ekonomive Familjare nga viti 2017 – nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Duhet cekur se rrallë herë ndodh që struktura e shpenzimeve nga viti në vit të ndryshojë substancialisht. Përjashtime bëjnë vitet kur shëndeti publik pëson ndryshime drastike, si në rastin konkret të pandemisë COVID 19 që u shfaq në fillim të vitit 2020 e më tej, e që ka pamundësuar regjistrimin e shpenzimeve nga xhepi të ekonomive familjare, që supozohet të jenë të konsiderueshme krahasuar me vitet paraprake.
- Vlen të theksohet se jo vetëm Kosova, por shumë shtete të tjera nuk e zhvillojnë çdo vit Anketën e Shpenzimeve Familjare.

DRAFT - Raporti NHA 2020 - Versioni 1.4


3. Demografia e Kosovës

Republika e Kosovë ka një sipërfaqe prej 10 905.25 km². Gjendet në pjesën e Evropës jug-lindore, e kufizuar me Shqipërinë në jug-perëndim, Malin e Zi veri-perëndim, Serbinë në veri-lindje dhe në jug me Maqedoninë.

Ndarja administrative e Kosovës

Aktualisht në Kosovë janë 38 komuna me 1.469 vendbanime të organizuara sipas ligjeve të vendit (ASK, Kosova në shifra 2020).

Figura 1. -Ndarja administrative e Kosovës.



Popullsia e përgjithshme rezidente me 2019 ishte 1,782.115. Moshë mesatare është vlerësuar të jetë 30,2 vite. Përqindja e popullsisë që jetonte në zonat rurale është 61,7%. Përqindja e popullsisë që jetonte në zonat urbane është 38,3% (2011). Dendësia e popullsisë ishte 163.42 banorë për km² (31 dhjetor 2019). Jetëgjatësia mesatare në

Kosovë është vlerësuar të jetë 76.7 vite, për meshkuj 74.1 vite, kurse për femra 79.4 vite.


Popullsia rezidente e Kosovës, për periudhën 01 janar–31 dhjetor 2020 u rritë për 16,071 banorë, dhe është 1.798.186 (ASK, 2020).

Tabela.1 - Popullsia sipas grupmoshave

Mosha	Pjesmarrja ne %
0 - 14 vjeçar	24%
15 - 64 vjeçar	67%
65 dhe më të vjetër	9%

Burimi: ASK, Vlerësimi i Popullsisë, 2020

Figura 2. -Jetëgjatësia e pritshme në lindje - 2011 (ASK, 2021)



Piramida e popullsisë

Piramidat e popullsisë paraqesin strukturën e popullsisë sipas viteve të regjistrimeve, moshës dhe gjinisë. Deri në regjistrimin e fundit të vitit 2011, rezultatet janë prezantuar në bazë të konceptimit të popullsisë rezidente dhe jo rezidente. Ndërsa në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, nuk është përfshirë popullsia që jetonte jashtë Kosovës për më shumë se 12 muaj. Gjithashtu duhet cekur se nuk është bërë regjistrimi i popullsisë në komunat: Mitrovica e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Në vitin 2011 Komuna e Mitrovicës nuk ishte e ndarë në komunën e Jugut dhe të Veriut, mirëpo popullsia e pjesës veriore nuk kishte marrë pjesë në regjistrim. Andaj për shkak të ndërrimit të metodologjisë, kemi disproporcion me numrin e përgjithshëm të popullsisë krahasuar me vitet e mëparshme.

Figura 3- Piramida e popullsisë - 2020 (ASK, 2020)




Tabela 2.- Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2020

Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2019)	Shtimi natyror (2020)	Bilanci i migrimëve (2020)	Rritja e përgjithshme për vitin 2020	Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2020 (31 dhjetor 2020)
1	Deçan	42.244	261	-25	236	42.480
2	Gjakovë	93.740	470	124	594	94.334
3	Glllogoc	60.525	687	-67	620	61.145
4	Gjilan	76.271	428	446	874	77.145
5	Dragash	33.983	-2	-34	-36	33.947
6	Istog	40.923	226	32	258	41.181
7	Kaçanik	34.420	332	-80	252	34.672
8	Klinë	40.076	403	11	414	40.490
9	Fushë Kosovë	38.960	408	580	988	39.948
10	Kamenicë	27.823	55	70	125	27.948
11	Mitrovicë	68.840	489	2	491	69.331
12	Mitr. e Veriut	12.043	-53	4	-49	11.994
13	Leposaviq	13.207	-51	46	-5	13.202
14	Lipjan	57.413	511	4	515	57.928
15	Novobërdë	7.121	8	29	37	7.158
16	Obiliq	17.899	263	56	319	18.218

17	Rahovec	56.414	471	162	633	57.047
18	Pejë	98.141	397	63	460	98.601
19	Podujevë	81.514	791	-283	508	82.022
20	Prishtinë	216.870	1543	368	1911	218.781
21	Prizren	193.123	1227	231	1458	194.581
22	Skenderaj	52.372	533	-191	342	52.714
23	Shtime	27.031	307	111	418	27.449
24	Shtërpçë	6.670	-40	-9	-49	6.621
25	Suharekë	57.203	671	321	992	58.195
26	Ferizaj	105.116	998	172	1170	106.286
27	Viti	47.507	404	-15	389	47.896
28	Vushtrri	62.026	609	290	899	62.925
29	Zubin Potok	6.648	16	0	16	6.664
30	Zveçan	7.336	-45	-1	-46	7.290
31	Malishevë	56.046	890	325	1215	57.261
32	Junik	6.364	9	10	19	6.383
33	Mamushë	5.834	33	7	40	5.874
34	Hani i Elezit	10.013	79	-2	77	10.090
35	Graçanicë	12.186	-9	53	44	12.230
36	Ranillug	3.785	-50	2	-48	3.737
37	Partesh	1.726	-29	2	-27	1.699
38	Klllokot	2.702	12	5	17	2.719
Gjithsej		1.782.115	13.252	2.819	16.071	1.798.186

4. Financimi i sistemit shëndetësor në retrospektivë

Republika e Kosovës ka nevoja dhe prioritete të shumta, të cilat kanë nevojë për financim nga buxheti i shtetit, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social të shoqërisë kosovare. Mundësitë buxhetore të vendit nuk mund të përballojnë të gjitha nevojat/kërkesat për financim, dhe kjo e sqaron mungesën e një strategjie të mirëfilltë për qëllimet e financimit të sektorit publik shëndetësor, në retrospektivë.

Buxhetimi i kufizuar i sektorit shëndetësor publik, duke shkaktuar shpërputhje serioze në mes të nevojave të qytetarit/pacientit, i detyron familjet që të marrin përsipër koston, në radhë të parë për medikamente dhe material shpenzues (barnat jashtë spitalore), si dhe për shërbime shëndetësore, në rastet kur këto shërbime nuk janë ofruar në sektorin publik.

Gjatë vitit 2020, Ministria e Shëndetësisë, duke u ballafaquar me pandeminë e COVID 19, ka kërkuar mbështetje shtesë financiare nga Qeveria, si dhe nga donatorët, për tu ballafaquar me të gjitha çështjet të cilat i ka vënë në pah pandemia.

Programi i trajtimit jashtë institucioneve publike shëndetësore (në vend ose jashtë vendit) i menaxhuar me mjete financiare të FSSH ka vazhduar, me synimin e mundësimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët, për ato shërbime të cilat nuk janë ofruar në sistemin publik shëndetësor.

Meqenëse këto mjete, të dedikuara nga shteti për Programin e TJISHP, prap nuk janë të mjaftueshme për të gjithë nevojat e qytetarëve për shërbime shëndetësore, prandaj një numër i qytetarëve kërkon trajtim jashtë vendit, duke shpenzuar shuma të konsiderueshme mjetesht financiare, e që fatkeqësisht, aktualisht nuk kemi mundësi ti regjistrojmë, dhe as nuk mund të bëjmë vlerësim objektiv, i cili do të mund të përdorej për qëllime të këtij raporti; përvec Anketës së ekonomive familjare të zhvilluar periodikisht nga ASK.

Ky fakt mund të spjegojë dallimet në vlerësim të shpenzimeve nga xhepi i qytetarit (anglisht -OOP) në mes të raporteve të llogarive kombëare të shëndetësisë dhe atyre të institucioneve ndërkombëtare.

Shpenzimet e Ministrisë së Shëndetësisë gjatë dekadës së kaluar kanë pasur këtë lëvizje si në vijim.

DRAFT - Raporti NHA 2020 - Versioni 1.02 Qershor 2020

Tabela 1. - Shpenzimet në Ministrinë e Shëndetësisë, për vitet 2010 – 2020, sipas kategorive ekonomike (në Euro)

Kategoria ekonomike	2020	2019	2018	2017	2016	2015	2014	2013	2012	2011	2010
Paga dhe shtesa	8,222,716	7,436,352	8,050,649	8,313,972	7,940,750	7,652,757	52,854,734	44,408,183	42,527,654	38,827,166	32,868,160
Mallra dhe shërbime	27,154,586	10,175,832	34,337,304	29,507,959	24,676,108	9,166,585	36,324,871	38,332,671	29,167,678	29,397,827	27,626,773
Shpenzime komunale	83,183	157,332	155,408	183,802	183,845	196,571	3,739,731	3,388,643	3,871,062	3,292,171	3,354,697
Subvencione dhe transfere	1,731,449	1,929,033	11,016,744	14,364,873	9,935,261	9,716,570	9,683,042	4,763,603	2,841,184	2,206,483	2,955,421
Pasuritë jofinanciare	14,165,306	6,454,579	4,999,345	5,213,494	7,146,481	4,990,190	8,807,593	8,628,310	8,897,476	6,158,817	7,999,286
Gjithsej shpenzime	51,357,239	26,153,128	58,559,449	57,584,100	49,882,445	31,722,673	111,409,971	99,521,409	87,305,055	79,882,464	74,804,338

*Në këtë tabelë janë prezantuar shpenzimet sipas kategorive ekonomike të Ministrisë së Shëndetësisë për periudhën 2010-2020.

Tabela 2. – Shpenzimet në SHSKUK, për vitet 2015 – 2020, sipas kategorive ekonomike (në Euro)

Kategoria ekonomike	2020	2019	2018	2017	2016	2015
Paga dhe shtesa	64,029,760	62,736,817	58,242,230	51,586,625	51,294,776.17	49,882,132
Mallra dhe shërbime	52,779,078	40,972,359	13,659,911	13,049,585	10,812,241	27,286,586
Shpenzime komunale	2,120,297	3,756,559	3,617,547	2,060,463	3,351,393	3,482,745
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-
Pasuritë jofinanciare	7,092,604	16,697,379	9,473,831.71	3,856,439	3,772,213	5,490,853
Gjithsej	126,021,739	124,163,113	84,993,519	70,553,112	69,230,624	86,142,316

* Në këtë tabelë janë prezantuar shpenzimet sipas kategorive ekonomike të SHSKUK-së për periudhën 2015-2020.

Tabela 5. – Shpenzimet në KPSH, për vitet 2010 – 2020, sipas kategorive ekonomike (në Euro)

Kategoritë ekonomike	2020	2019	2018	2017	2016	2015	2014	2013	2012	2011	2010
Paga dhe shtesa	44,199,382	42,348,732	40,971,614	39,296,553	39,363,941	38,276,205	34,381,291	31,133,814	30,963,725	29,881,861	25,385,411
Mallra dhe shërbime	22,357,630	7,860,596	7,666,861	6,228,039	5,794,995	5,859,230	5,465,355	6,199,678	6,020,434	4,972,348	4,465,575
Shpenzime komunale	1,379,296	1,451,808	1,396,815	1,407,892	1,452,879	1,477,955	1,319,799	1,455,494	1,406,139	1,412,824	1,390,091
Subvencione dhe transfere	2,039,446	1,255,284	1,024,825	714,106	685,918	794,023	961,902	1,075,243	837,048	866,047	796,735
Pasuritë jo financiare	6,741,846	8,485,716	6,230,629	4,594,592	3,997,867	4,841,654	7,036,755	5,822,963	6,085,427	6,477,587	4,895,421
Gjithsej	76,717,600	61,402,137	57,290,744	52,241,181	51,295,600	51,249,067	49,165,102	45,687,192	45,312,774	43,610,666	36,933,233

*Në këtë tabelë vërejmë se buxheti i ndarë për shëndetësinë në nivelin parësor (KPSH) ka pasur një trend rritje ndër vite, kryesisht në kategorinë Rroga dhe Paga për fuqizim të kapaciteteve me staf shëndetësor; duke pasë parasysh edhe rritjen e madhe të shpenzimeve për mallna dhe shërbime në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID 19.

- Ndërsa sa i përket shpenzimeve të dikastereve tjera të sektorit publik për shëndetësi për vitin 2020, shih tabelën në vijim.

Tabela 3. – Shpenzimet e dikastereve të tjera të sektorit publik për shëndetësi, ne vitin 2020 (në Euro):

Institucioni	2020	2019
Ministria e Drejtësisë	1,103,599	130,879
Ministria e Mbrojtjes	667,635	
AKSP	16,857	
ASHNA	39,025	
Ministria e Puneve te Brendshme	310,601	25,723
Gjithsej shpenzime	2,137,717	156,603

*Në këtë tabelë shohim se edhe ministritë tjera shpenzojnë për shëndetësi kryesisht në aspektin preventiv dhe kujdes parësor:

Tabela 4. -Shpenzimet për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, për vitin 2020, sipas kategorive ekonomike (në Euro):

Kategoria ekonomike	2020	2019
Paga dhe shtesa	327,527	357,960
Mallra dhe shërbime	294,288	269,304
Shpenzime komunale	17,091	22,217
Subvencione dhe transfere	7,999,984	8,699,979
Pasuritë jofinanciare	153,687	61,804
Gjithsej shpenzime	8,792,577	9,411,265

*Në këtë tabelë vërejmë se buxheti i ndarë (sipas Ligjit të Buxhetit) për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore kryesisht është për kategorinë Subvencione dhe Transfere për Trajtim Mjekesor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike.

- Tabela në vijim bën përmbledhjen e shpenzimeve totale në sektorin publik përgjatë periudhës 2010-2020. Kjo tabelë tregon se shpenzimet në shëndetësi nga sektori publik gjatë kësaj periudhe kanë përjetuar një rritje prej 2.5 herë më të lartë (nga mbi 111 milionë në 2010 në mbi 272 milionë në 2020).

Tabela 5. -Shpenzimet e sektorit publik për shëndetësi, 2010-2020 (në Euro):

Institucionet	2020	2019	2018	2017	2016	2015	2014	2013	2012	2011	2010
Ministria e Shëndetësisë ^e	51,357,239	26,153,128	58,559,449	57,584,100	49,882,445	31,722,673	111,409,971	99,521,409	87,305,055	79,882,464	74,804,338
SHSKUK	126,021,739	124,163,113	84,993,519	70,553,112	69,230,624	86,142,316					
Komunat (KPSH)	76,717,600	61,402,137	57,290,744	52,241,181	51,295,600	51,249,067	49,165,102	45,687,192	45,312,774	43,610,666	36,933,233
FSSH	8,792,577	9,411,265									
Donacionet	7,761,394										
Ministritë tjera	2,137,717	156,603	1,237,309								
Gjithsej shpenzime	272,788,266	221,286,245	202,081,021	180,378,393	170,408,669	169,114,056	160,575,073	145,208,601	132,617,829	123,493,130	111,737,571

*Në këtë tabelë janë prezantuar shpenzimet për shëndetësi të financuara direkt nga granti qeveritar.

Ndërsa, tabela në vijim përmbledh shpenzimet, apo financimin e sistemit shëndetësor, nga sektori publik dhe privat. Kjo tabelë njëkohësisht shpjegon edhe metodologjinë hap-pas-hapi se si kalkulohe, apo thënë më mirë - vlerësohen, shpenzimet private në shëndetësi - sipas metodologjisë së propozuar nga OBSH. Kjo tabelë tregon qartazi se shpenzimet në shëndetësi, si raport ndaj BPV-së nominale, janë rritur gjatë periudhës në fjalë.

Tabela 6. -BPV, dhe % e BPV -së për shëndetësi (total) 2015-2020 (në milionë Euro)

#	2020	2019	2018	2017	2016	2015	Burimi i të dhënave dhe shpjegime shtesë
BPV Nominale	6771.6	7,056.20	6,671.50	6,356.50	6,037.30	5,674.40	Burimi: vitet 2015-2019: ASK
Konsumi final i ekonomive shtëpiake	5718.0	5,621.20	5,296.10	5,009.00	4,910.50	4,803.70	Burimi: vitet 2015-2019: ASK
Shpenzime private ne shëndetësi (% e konsumit final te ekonomive shtëpiake)	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	Burimi: ASK
Shpenzime private	188.3	168.64	158.88	150.27	147.31	144.11	$Kalkulim = Konsumi\ final\ i\ ekonomive\ shtëpiake\ (LLK) \times Shpenzime\ private\ në\ shëndetësi\ (%\ e\ konsumit\ final\ te\ ekonomive\ shtëpiake\ (ABEF)) + Sigurimet\ shëndetësore$
Shpenzime publike	272.78	221.29	202,09	180.38	170.41	169.11	Të dhëna aktuale nga Tabela 8.
% e GDP për shëndetësi publike	4.00%	3.20%	3.00%	2.80%	2.80%	3.00%	$Kalkulim = Gjithsej\ Shpenzime\ Publike\ ne\ Shëndetësi / BPV\ Nominale$
% e GDP për shpenzime private në shëndetësi	2.8%	2.40%	2.40%	2.40%	2.40%	2.50%	$Kalkulim = Gjithsej\ Shpenzime\ Private\ ne\ Shëndetësi / BPV\ Nominale$
% e GDP për shëndetësi	6.8%	5.60%	5.40%	5.20%	5.30%	5.50%	$Kalkulim = (Gjithsej\ Shpenzime\ Publike\ ne\ Shëndetësi + Gjithsej\ Shpenzime\ Private\ ne\ Shëndetësi) / BPV\ Nominale$

5. Financimi i sistemit shëndetësor në vitin 2020

Viti 2020 ka qenë vit sfide për gjithë botën, dhe në veçanti për vendin tonë, për shkak të pandemisë së COVID-19.

Ky seksion fokusohet vetëm në shpenzimet në shëndetësi, apo financimin e sistemit shëndetësor, gjatë vitit 2020. Së pari ofrohen të dhëna nga sektori publik, e më pas nga ai privat.

Para shpalesjes së të dhënave të shpenzimeve nga ana e sektorit publik dhe atij privat, vlen të shpalosen të dhëna edhe mbi kontekstin ekonomik të vendit tonë. Gjatë vitit 2020 sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV reale shënoi rënie reale prej 5.3% ndërsa ajo nominale shënoi rënie prej 4.0%. Komponentët (nga ana e metodës së shpenzimeve të BPV-së) që kontribuan në këtë rënie reale ishin investimet totale dhe eksporti i shërbimeve, ndërkohë që konsumi real dhe eksporti i mallrave shënuan rritje të kënaqshme.

Financimi shëndetësor gjatë 2020 vazhdoi të realizohet kryesisht nga Buxheti i Republike së Kosovës, të hyrat vetanake dhe nga huamarrja nga Banka Botërore. Të hyrat vetanake në Kujdesin Parësor Shëndetësor përdoren për të financuar pjesërisht realizimin e projekteve kapitale për shëndetësinë komunale.

Reformimi i sistemit shëndetësor, gjatë vitit 2015 ka mundësuar ndarjen e SHSKUK nga Ministria e Shëndetësisë, si organizatë e pavarur buxhetore, kurse në vitin 2019 Fondi i Sigurimeve Shëndetësore gjithashtu është ndare si OB e pavarur.

5.1. Sektori publik

Sektori publik shëndetësor në Kosovë përbëhet nga të gjitha institucionet shëndetësore dhe administrative të cilat janë në varësi të buxhetit të shtetit për të zhvilluar aktivitetet e tyre, përfshirë dikastere të ndryshme qeveritare dhe agjencionet ekzekutive të dikastereve të cilat kanë detyrë monitorimi e zbatimit të ligjshmërisë në sektor.

Para se të shfaqen të gjitha të dhënat mbi shpenzimet publike, janë përpiluar edhe ty tabela: kreditë që i përkasin MSH – sipas kategorive ekonomike, si dhe donacionet e pranuar nga MSH te cilat kanë kaluar përmes buxhetit të shtetit të ndara sipas kategorive ekonomike. Për më shumë shih tabelat më poshtë.

Tabela 7. -Kredi në MSH, sipas kategorive ekonomike

Kategoria ekonomike	Shuma
Paga dhe shtesa	316,575
Mallra dhe shërbime	11,541,910
Shpenzime komunale	-
Subvencione dhe transfere	53,908
Pasuritë jofinanciare	10,125,856
Gjithsej	22,038,248

*Kredit te cilat kane kaluar permes buxhetit te shtetit.

Tabela 8. -Donacionet, sipas kategorive ekonomike

Kategoritë ekonomike	Ministria e Shëndetësisë	SHSKUK	KPSH
Paga dhe shtesa	10,725	15,380	
Mallra dhe shërbime	818,640	9,646	10,061
Shpenzime komunale			
Subvencione dhe transfere			802
Pasuritë jofinanciare	597,386		39,435
Gjithsej	1,426,752	25,026	49,496

* Donacionet te cilat kane kaluar permes buxhetit te shtetit.

Tabela 9. -Donacionet e pranuar nga institucionet shëndetësorë

Donatori	Shuma
Donacionet ne SHSKUK si Investime Kapitale	2,598,861
Donacionet ne SHSKUK si Mallra dhe Sherbime	5,159,032
Donacionet ne MSH si Mallra dhe Sherbime	3,500
Gjithsej	7,761,394

* Donacionet të pranuar nga institucionet shëndetësore që nuk kanë kaluar përmes buxhetit të shtetit.

Tabela në vijim shfaq të dhënat e shpenzimeve nga ana e sektorit publik, të ndara sipas kategorive ekonomike si dhe organizatës buxhetore relevante. Shihet se shpenzuesi kryesor është SHSKUK, më pas komunat, e pastaj MSH, e tj. Gjithsej shpenzime nga sektori publik për vitin 2020 ishin mbi 272 milionë euro.

Tabela 10. -Përmbledhje: Struktura e shpenzimeve për shpenzuesit kryesor publik (me donacionet), per vitin 2020

Kategoria ekonomike	MSH	SHSKUK	Komunat	Fondi	MD	MPB	MM	AKSP	ASHNA	Donacionet	TOTAL
Paga dhe shtesa	8,222,716	64,029,760	44,199,382	327,527	933,398	17,714	78,558	16,857	31,879		117,857,790
Mallra dhe shërbime	27,154,586	52,779,078	22,357,630	294,288	105,645		293,501		7,146	5,162,532	108,154,407
Shpenzime komunale	83,183	2,120,297	1,379,296	17,091		178	21,060				3,621,105
Subvencione dhe transfere	1,731,449		2,039,446	7,999,984	64,556	292,709					12,128,145
Pasuritë jofinanciare	14,165,306	7,092,604	6,741,846	153,687			274,516			2,598,861	31,026,820
Gjithsej shpenzime	51,357,239	126,021,739	76,717,600	8,792,577	1,103,599	310,601	667,635	16,857	39,025	7,761,394	272,788,266

*Ne kete tabele jane përmbledhur te gjitha shpenzimet ne shendetsi nga sektori publik dhe donacionet.

DRAFT - Raporti NHA 2020

5.2. Sektori Privat

Sektori privat shëndetësor përbëhet nga institucionet private shëndetësore, të licencuara nga Ministria e Shëndetësisë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të Ligjit të shëndetësisë dhe akteve nënligjore të cilat e rregullojnë këtë lëmi.

Shërbimet që ofrohen në sektorin privat janë shërbime spitalore – ditore dhe stacionare, shërbime specialistike jashtë spitalore (ambulatorë), diagnostika laboratorike dhe imazherike, fizioterapia me rehabilitim ambulator dhe stacionar, etj.

Këto shpenzime janë të bazuara në vlerësim, i cili është bërë sipas metodologjisë së sygjëruar nga OBSH. Për më shumë detaje se si është bërë vlerësimi, shih kapitullin e metodologjisë dhe tabelën më lartë me emrin: BPV, dhe % e BPV -së për shëndetësi (total) 2015-20120 (në milion Euro). Baza e të dhënave për këtë vlerësim janë: Llogaritë Kombëtare Vjetore 2008- 2020 dhe Anketa e Buxhetit Familjar (2017) nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës.

Tabela 11. –Shpenzimet nga xhepi i qytetarit për shëndetësi të disagreguara në nënkategori, 2020:

Shërbimi / shpenzimi	2020	2019
Medikamente	116,224,024	114,256,224
Produkte farmaceutike të tjera, përveç medikamenteve	45,172	44,407
Pajisjet mjekësore dhe mjetet tjera ndihmëse	27,620	27,153
Shërbimet shëndetësore jashtë spitalore (ambulatorë) publike	2,634,554	2,589,948
Shërbimet shëndetësore jashtë spitalore (ambulatorë) private	15,963,152	15,692,879
Shërbimet stomatologjike publike	1,528,555	1,502,675
Shërbimet stomatologjike private	5,790,157	5,692,124
Analizat mjekësore, laborator, radioskopia (Roentgen) publike	2,132,943	2,096,830
Analizat mjekësore, laborator, radioskopia (Roentgen) private	7,951,070	7,816,450
Shërbimet spitalore publike	1,352,874	1,329,968
Shërbime spitalore private	5,183,639	5,095,875
Akomodimi, ushqimi, transporti me autoambulancë në Kosovë	158,969	156,278
Shërbime shëndetësore jashtë vendit	11,269,652	11,078,844
Akomodimi, ushqimi, transporti me autoambulancë jashtë vendit	1,222,840	1,202,136
Ilaçe tradicionale	-	-
Shërbime të tjera mjekësore	54,748	53,821
Gjithsej	171,539,970.0	168,635,610

**Nga tabela më lart vërehet se shumica e shpenzimeve nga xhepi (private) shkojnë në medikamente (mbi 116 milionë euro) si dhe shërbime shëndetësore jashtë spitalore (ambulatorë) private (gati 16 milionë euro). Kategoria e tretë me më së shumti shpenzime është ajo e shërbimeve shëndetësore jashtë vendit me mbi 11 milionë euro.*

Të dhënat janë siguruar nga Banka Qendrore e Kosovës dhe Agjencioni i Statistikave të Kosovës dhe pasqyrojnë shpenzimet lidhur me Sigurimet shëndetësore vullnetare në vendin tonë. Këto të dhëna janë pjesë e kalkulimeve në tabelën më lartë, mirëpo vetëm ofrojnë një perspektivë tjetër me të dhëna shtesë.

Tabela 15.-Shpenzimet për sigurimin shëndetësor vullnetar, 2020

Primet e shkruara bruto nga sigurimi i "Aksidentit dhe shëndetit"	Primet e shkruara
Viti 2020	16,720,116
Viti 2019	19,600,812

**Ne kete tabele jane prezantuar primi i paguar nga qytetaret e Kosoves per policat e sigurimeve ne aksidente dhe shendetesore ne kompanit private te sigurimeve.*

Tabela 126. -Total shpenzimet për shëndetësi ne vitin 2020

Kategoria ekonomike	MSH	SHSKUK	Komunat	Fondi	MD	MPB	MM	ASHNA	Donacionet	Paratë e shpenzuara nga xhepi	Sigurimet Sh.Private	TOTAL
Paga dhe shtesa	8,222,716	64,029,760	44,199,382	327,527	933,398	17,714	78,558	31,879	-	-	-	117,840,934
Mallra dhe shërbime	27,154,586	52,779,078	22,358,062	294,288	105,645	-	293,501	7,146	5,162,532	171,539,970	16,720,116	296,414,924
Shpenzime komunale	83,183	2,120,297	1,379,297	17,091	-	178	21,060	-	-	-	-	3,621,106
Subvencione dhe transfere	1,731,449	-	2,039,446	7,999,984	64,556	292,709	-	-	-	-	-	12,128,144
Pasuritë jofinanciare	14,165,306	7,092,604	6,741,846	153,687	-	-	274,516	-	2,598,861	-	-	31,026,820
Gjithsej shpenzimet	51,357,240	126,021,739	76,718,033	8,792,577	1,103,599	310,601	667,635	39,025	7,761,393	171,539,970	16,720,116	461,031,928

*Ne kete tabele jane përmbledhur te gjitha shpenzimet per shëndetësi ne Kosove per vitin 2020, te ndara sipas kategorive ekonomike te shpenzimeve dhe nga burimet e tyre.

6. Konkluzione dhe rekomandime

- Konkluzionet e raportit të llogarive kombëtare shëndetësore për 2020 janë listuar në vijim:
 - Mungesa e sigurimeve shëndetësore, ka shkaktuar zhvendosjen e kostos tek xhepi i qytetarit, në radhë të parë për medikamente dhe material shpenzues (barnat jashtë spitalore), si dhe për shërbime shëndetësore, në rastet kur këto shërbime nuk janë ofruar në sektorin publik.
 - Shpenzimet nga sektori privat, apo siç quhen shpenzimet nga xhepi (*out-of-pocket payments*), janë të vetmet shpenzime për të cilat janë përdorur supozime për t'i vlerësuar meqë bazohen në të dhënat të rrumbullakuara (pa presje decimale), e ku çdo shifër shtesë mund të ndryshojë shumën totale konsiderueshëm.
 - Ndryshe nga shpenzimet nga xhepi, të gjitha shpenzimet tjera janë aktuale, dhe për këtë arsye nuk janë përdorur supozime për t'i vlerësuar ato; dhe
 - Në raportin e vitit 2020, ashtu si edhe në atë paraprak, vërehet mungesa e informatave e përditësuara nga institucionet gjegjëse për shëndetësi.

- Rekomandimet e raportit të llogarive kombëtare shëndetësore për 2019 janë listuar në vijim:
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria të krijojnë një mekanizëm që do të ndikojë në uljen e nivelit të financimit nga xhepi. Dy rekomandime nga komisioni në fjalë janë:
 - Përditësimi i listës esenciale të barnave; dhe
 - Rregullimi i çmimeve të barnave përmes akteve ligjore.
 - Te jete prioritet ndër institucional funksionalizimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, i cili do të ndikojë në uljen e nivelit të financimit nga xhepi si dhe uljen e varfërisë së popullatës si pasojë e shpenzimeve të larta për shëndetësi.

7. Anekset – Grafikët nga softueri HAPT

Aneksi 1 – Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetësi nga te gjitha nivelet e financimit

Select type of data source:


All

FY2020/2020

Total expenditure amount: 461,031,929.09 Euros

Select accounts:

General



Dh.

Aneksi 2 – Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetsi te financuara nga Granti Qeveritar


FY2020/2020

Total expenditure amount: 265,010,449.32 Euros

Select type of data source:
 Government

Select data source:
 All

Select accounts:
 General



DRAFT - Ra

Aneksi 3 – Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetësi nga kompanitë private te sigurimeve

Select type of data source:

Insurance

Select data source:


All

Select accounts:

General

FY2020/2020

Total expenditure amount: 16,720,116.00 Euros




Aneksi 4 – Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetësi nga pagesat nga xhepi

Select type of data source:
Miscellaneous
Select data source:
All
Select accounts:
General

FY2020/2020

Total expenditure amount: 171,539,970.00 Euros



Aneksi 5 – Tabela HAPT: Shpenzimet totale ne shëndetësi te financuara nga donatorët

Select type of data source:

Donor

Select data source:


All

Select accounts:

General

FY2020/2020

Total expenditure amount: 7,761,393.77 Euros



U.S.